

LIGJ PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË INVESTIMEVE

TEKST I KONSOLIDUAR **1**

Lënda e ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen llojet, lartësia, kushtet, mënyra dhe procedura për ndarjen e mbështetjes financiare të investimeve të subjekteve afariste të cilat do të investojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 2

Ky ligj paraqet skemë të ndihmës në pajtim me rregullat me të cilat rregullohet kontrolli i ndihmës shtetërore.

Qëllimi i ligjit

Neni 3

Qëllimi i këtij ligji është nxitja e rritjes dhe zhvillimit ekonomik në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes mbështetjes së investimeve për rritjen e konkurrencës së ekonomisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të punësimeve.

Kuptimi i nocioneve të përdorura

Neni 4

Nacionet e veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

- "Dhënës i ndihmës shtetërore" është Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut., **2**
- "Subjekti afarist" është tregtari i regjistruar në Regjistrin e shoqërive tregtare në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut., **3**
- "Furnizues" është secili subjekt afarist i cili nuk është në mënyrë kapitale apo në çfarëdo mënyre tjetër në pajtim me ligjin i lidhur me shfrytëzuesin e mbështetjes financiare të këtij ligji dhe i cili kryen procese dhe operacioneve paraprake mbi prodhimin i cili dorëzohet dhe inkorporohet në prodhimin e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare,
- "Ndihma shtetërore" është ndihma e dhënë nga dhënësi i ndihmës shtetërore në formë të mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj,
- "Hulumtim industrial" është hulumtim i planifikuar ose kritik me qëllim të përvetësimit të diturive dhe të shkathtësive të reja për zhvillimin e produkteve, të proceseve ose të shërbimeve të reja, ose për përmirësimin e konsiderueshëm të produkteve, të proceseve dhe të shërbimeve ekzistuese;
- "Forma e organizimit për zhvillim teknologjik dhe hulumtim" është vendi brenda ose jashtë kapacitetit prodhues të shfrytëzuesit të mbështetjes financiare ku ai zhvillon ose krijon produkte të larta

teknologjike, teknologji ose procese prodhuese, me ç'rast zhvillimi i produktit ose inovacionit nuk përfshijnë modifikime të rregullta dhe të zakonshme të produkteve, linjave prodhuese, proceseve prodhuese, shërbimeve ekzistuese dhe aktiviteteve të tjera rrjedhëse ndonëse ato nuk sjellin ndryshime. Procesi i prodhimitarisë i subjektit afariste vetvetiu nuk konsiderohet për aktivitet të formës organizative për zhvillim teknologjik dhe hulumtim;

7. "Personel me kualifikim të lartë" janë hulumtues, inxhinierë, disenjatorë dhe menaxherë marketingu me arsim të lartë dhe me së paku pesë vite përvojë të rëndësishme profesionale.

8. "Shpenzime të arsyetuara investuese" janë shpenzimet për investime në mjetet materiale dhe jomateriale për nevojat e projektit investues,

9. "Mjete materiale" janë të gjitha mjetet si toka, ndërtesa, pajisje, stabilimente dhe makina të reja të nevojshme për realizimin e projektit investues,

10. "Mjete jomateriale" janë investimet në transfer të teknologjisë, marrja e patentëve, licencave, njohuria dhe përvoja (know-how), të drejtat tjera me pronësi intelektuale të pranuar në legjislacionin nacional në vendin e prejardhjes së të drejtës përkatësisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut. apo njohuria teknike e jopatentuar e nevojshme për realizimin e projektit investues, **4**

11. "Shfrytëzues i mbështetjes financiare" është çdo subjekt afarist të cilit i është ndarë mbështetja financiare për realizimin e projektit investues në pajtim me këtë ligj,

12. "Investime fillestare produktive" janë investimet në mjetet materiale dhe/ose jomateriale të lidhura me:

- themelimin e subjektit të ri afarist;
- zgjerimin e kapacitetit të prodhimit të subjektit afarist ekzistues;
- vendosje të procesit të prodhimit;
- futjen e prodhimeve të reja;
- ndryshimin esencial në tërë procesin e prodhimit të subjektit afarist ekzistues dhe
- fitimin e mjeteve themelore të subjektit afarist që është në procedurë të falimentimit, me kusht këto të blihen nga subjekti i cili nuk është në lidhshmëri kapitale apo lidhshmëri tjetër në pajtim me ligjin me subjektin nga i cili blihen mjetet. **5**

13. "Makinë e re" është çdo makinë, pajisje apo stabiliment i prodhuar jo më herët se dy vjet nga data e blerjes, dhe është furnizuar ose prodhuar nga shfrytëzuesi i mbështetjes financiare me kushte reale të tregut dhe çmim të përcaktuar në pajtim me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të pranuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

14. "Projekt investues" janë të gjitha aktivitetet që do të merren nga subjekti afarist dhe të cilat përfshijnë investime në ndërtimin e objekteve të reja, përkatësisht përshtatjen, rekonstrukcionin apo ndërtimin plotësues të objekteve ekzistuese, furnizimin e pajisjes, makinave dhe stabilimenteve dhe hapjen e vendeve të reja të punës në pajtim me planin afarist, si dhe investime në mjete jomateriale,

15. "Projekt i madh investues" është projekti investues me vlerë mbi 50.000.000 euro në kundërvlerë me denarë,

16. Fillimi i realizimit të projektit investues" është data e përcaktuar në marrëveshjen për mbështetje financiare të investimeve që do të bashkëveprojë me llojin e projektit investues.

Kohëzgjatja dhe mirëmbajtja e projektit investues

Neni 5

(1) Projekti investues për të cilin ndahet mbështetje financiare në përputhje me këtë ligj nuk mund të zgjasë më gjatë se pesë vite nga dita e fillimit të realizimit të projektit investues.

(2) Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare i cili ka marrë mbështetje financiare në përputhje me këtë ligj është i detyruar të mirëmbajë investimin për një periudhë prej së paku 5 viteve pas datës së përfundimit të projektit investues.

Pjesëmarrja e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare në financim

Neni 6

Pjesëmarrja e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare në investim duhet të arrijë së paku 25% të shpenzimeve të përgjithshme dhe të arsyeshme investuese përmes mjeteve personale apo nga burimet tjera të financimit që nuk paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore.

Obligimi për paraqitjen e projekteve të mëdha

Neni 7

Për secilin projekt të madh investues, dhënësi i ndihmës shtetërore detyrimisht e njofton Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në pajtim me ligjin.

Kumulacioni i mbështetjes financiare

Neni 8

(1) Mbështetja e përgjithshme financiare e cila mund të paguhet në pajtim me këtë ligj dhe ligj tjetër nuk mund të tejkalojë 50% nga lartësia e shpenzimeve të arsyeshme investuese të realizuara.

(2) Për projekte të mëdha investuese lartësia e mbështetjes financiare të këtij ligji është:

- deri më 50% nga shpenzimet e arsyeshme investuese për projektin investues deri më 50.000.000 euro;
- deri më 25% për pjesën e shpenzimeve të arsyeshme investuese për projektin investues prej 50.000.000 euro deri më 100.000.000 euro dhe
- deri më 17% për pjesën e shpenzimeve të arsyeshme investuese për projektin investues që tejkalojnë 100.000.000 euro.

(3) Intensiteti maksimal i mbështetjes financiare sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk ka të bëjë me mbështetjen financiare që jepet dhe paguhet për vendosjen e formave organizative për zhvillim teknologjik dhe hulumtim. Intensiteti maksimal ndaj shfrytëzuesit për mbështetje financiare që ndahet dhe paguhet për vendosjen e formave organizative për zhvillim teknologjik është përcaktuar në nenin 20 të këtij ligji.

Subjektet që mund të jenë shfrytëzuese të mbështetjes financiare

Neni 9


(1) Subjektet që mund të jenë shfrytëzuese të mbështetjes financiare janë subjektet afariste:

- të cilët kanë filluar investim produktiv fillestar dhe
- të cilat kanë realizuar rritjen e të ardhurave të përgjithshme nga puna në vitin e fundit në lidhje me mesataren e tri viteve paraprake apo për periudhë më të shkurtër nëse subjekti afarist është regjistruar dhe ka filluar me veprimtari në periudhën më të shkurtër se katër vjet të llogaritur nga dita e dorëzimit

të kërkesës për ndarjen e mbështetjes financiare dhe - te të cilët numri mesatar i të punësuarve në vitin e fundit në raport me mesataren prej tri viteve paraprake nuk është zvogëluar për më tepër se 5% ose për periudhë më të shkurtër kohore nëse subjekti afarist është i regjistruar dhe ka filluar me veprimtari në periudhë më të shkurtër se katër vite llogaritur prej ditës së parashtrimit të kërkesës për ndarje të ndihmës financiare.

(2) Shfrytëzues të mbështetjes financiare mund të jenë edhe subjekte të sapoformuara afariste të cilat nuk i plotësojnë kushtet nga paragrafi (1) alinetë 2 dhe 3 të këtij neni."

(3) Shfrytëzues të mbështetjes financiare mund të jenë edhe subjektet afariste të industrisë së përpunimit të lëkurës dhe tekstilit, me ç'rast për këto subjekte afariste nuk aplikohen kushtet nga paragrafi (1) alineja 3 e këtij neni.

(4) Shfrytëzues të mbështetjes financiare mund të jenë edhe subjektet afariste që ushtrojnë veprimtari të lidhura me prodhimtarinë e dedikuar (armatim dhe pajisje ushtarake) 

(5) Subjekti afarist do të fitojë të drejtën për të shfrytëzuar mbështetjen financiare në përputhje me këtë ligj nëse i plotëson në mënyrë kumulative kushtet e parashikuara sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Subjektet që nuk mund të jenë shfrytëzues të mbështetjes financiare

Neni 10

Mbështetja financiare në pajtim me këtë ligj nuk mund t'u ndahet subjekteve:
- ndërmarrje publike të themeluara dhe në pronësi të shtetit dhe njësisve të vetëqeverisjes lokale, shoqëri tregtare që janë në pronësi të plotë ose të pjesshme të shtetit dhe njësisve të vetëqeverisjes lokale, partneritete publike-private në të cilat merr pjesë shteti ose njësitë e vetëqeverisjes lokale;
- të cilët janë bartës të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, por vetëm nëse marrin mekanizma për mbështetje (tarifa ose shpërblime të parapëlqyera), përkatësisht shesin energjinë elektrike me çmime të rregulluara;
- të cilët ushtrojnë veprimtari të rregulluar çmimin e të cilës e përcakton trup i pavarur rregullator;
- shfrytëzues të së drejtës për koncesione të mallrave me interes të përgjithshëm, por vetëm nëse koncesioni shfrytëzohet për një investim fillestar produktiv;
- të cilat prodhojnë mallra me akcizë dhe vetëm për pjesën e prodhimit të mallrave të akcizës;
- të cilët kryejnë veprimtari nga fusha e bujqësisë primare, pylltarisë dhe peshkatarisë, përveç veprimtarive përpunuese në bujqësi, pylltari dhe peshkataritë të cilat nuk shfrytëzojnë subvencione;
- të cilët kryejnë veprimtari ndërtimore në lidhje me ndërtimin dhe shitjen e banesave dhe ndërtesave banesore dhe afariste edhe atë vetëm për pjesën e veprimtarisë ndërtimore, ndërtim dhe shitje e banesave, ndërtesave banesore dhe afariste.

Kufizimi i mbështetjes financiare

Neni 11

Mbledhja financiare për realizimin e projektit investues në pajtim me këtë ligj nuk mund t'i ndahet subjektit afarist në zonat zhvillimore industriale teknologjike për shpenzimet e njëjta të arsyeshme si dhe subjekteve tjera afariste jashtë zonave zhvillimore industriale teknologjike për shpenzimet e njëjta të arsyeshme për të cilat është ndarë ndihma shtetërore.

Realizimi i mbështetjes financiare

Neni 12

Mbështetja financiare që u ndahet subjekteve afariste në përputhje me këtë ligj do të realizohet në nivel vjetor me pagesë të drejtpërdrejtë në llogarinë e përdoruesit në procedurën e përcaktuar me këtë ligj dhe në përputhje me marrëveshjen e lidhur për mbështetje financiare.

Kthimi i zbatimit të mbështetjes financiare në rast të mospërbushjes së obligimeve të marra

Neni 13

Në rast të mospërbushjes së obligimeve të marra në bazë të marrëveshjes së lidhur për ndarjen e mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj, shfrytëzuesi i mbështetjes financiare ka për detyrë ta kthejë zbatimin e mbështetjes financiare në vëllimin, afatin dhe në mënyrën e rregulluar me marrëveshjen për mbështetjen financiare.

Llojet e mbështetjes financiare

Neni 14

(1) Lloje të mbështetjes financiare për investime dhe aftësi konkurruese janë: **Z**

- a) Mbështetje për punësime të reja;
- b) Mbështetje për vendosjen dhe avancimin e bashkëpunimit me furnizues nga Republika e Maqedonisë së Veriut;
- c) Mbështetje për vendosjen e formave të organizuara për zhvillim teknologjik dhe hulumtim;
- ç) Mbështetje për projekte investuese me interes të rëndësishëm ekonomik;
- d) Mbështetje për rritje të investimeve kapitale dhe të ardhurave;
- dh) Mbështetje për marrjen përsipër të subjekteve afariste në vështirësi dhe
- e) mbështetje për rritjen e aftësisë konkurruese në tregun.

(2) Subjekti afarist mund të parashtrojë kërkesë për lidhjen e marrëveshjes për mbështetje financiare për disa lloje të mbështetjes financiare për investime dhe aftësi konkurruese të paragrafit (1) të këtij neni.

Mbështetja financiare për punësime të reja

Neni 15

(1) Mbështetja financiare për punësime të reja në kuadër të projektit investues ndahet për punësime të reja të shtetasve të Republikës së Maqedonisë së Veriut me orar të plotë të punës.

(2) Subjekti afarist i cili do të paguajë rrogë neto mujore e cila është më pak për 50% më e lartë nga rroga neto minimale të paraparë me Ligjin për rrogë minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka të drejtën e mbështetjes financiare në shumë prej 20% të rrogës së paguar neto mujore për çdo punësim të ri gjatë vitit paraprak, për muajt për të cilët është paguar neto pagë.

(3) Shuma vjetore maksimale e mbështetjes financiare nga paragrafi (2) i këtij neni e cila mund të ndahet për një punësim të ri është 4.400 euro. Shuma vjetore maksimale e mbështetjes financiare përcaktohet në mënyrë proporcionale për periudhën nga dita e punësimit.

(4) Mbështetja financiare e paragrafit (2) në këtë nen nuk mund të paguhet për periudhë kohore më të gjatë se pesë vite.

Neni 16

Për realizimin e mbështetjes financiare të nenit 15 të këtij ligji, së paku 50% e të sapopunësuarve gjatë vitit për të cilin kërkohet mbështetje financiare duhet të jenë persona që plotësojnë të paktën një nga kushtet si më poshtë:

- të paktën 3 muaj para punësimit të mos kenë themeluar marrëdhënie pune dhe të paktën 12 muaj para punësimit të mos kenë qenë të punësuar te shfrytëzuesi i mbështetjes financiare ose te ndonjë subjekt i ndërlidhur afarist; ose
- krijojnë për herë të parë marrëdhënie pune me të; ose
- punësimi i tyre i fundit të jetë ndërprerë për shkak të hapjes së procedurës së falimentimit ose likuidimit; ose
- para punësimit të ketë qenë i punësuar në administratën publike ose shtetërore.

Mbështetja financiare për vendosjen dhe përparimin e bashkëpunimit me furnizuesit e regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Neni 17

(1) Mbështetja financiare për vendosjen dhe avancimin e bashkëpunimit afarist me furnizues ka të bëjë me subjekte afariste që veprojnë në zonat industriale të zhvillimit teknologjik, dhe të cilat do të furnizojnë dhe përfshijnë produktet nga furnizuesit në produktin përfundimtar të dedikuar për eksport.

(2) Mbështetja financiare e paragrafit (1) të këtij neni arrin 10% të vlerës së furnizimeve të përgjithshme të realizuara publike të produkteve nga furnizuesit që përfshihen në produktin e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare në vitin paraprak, me kusht që furnizimet e përgjithshme nga furnizuesit të jenë së paku 7,5% e furnizimeve të përgjithshme të shfrytëzuesit të mbështetjes financiare në vitin paraprak.

(3) Shuma vjetore maksimale e mbështetjes financiare nga paragrafi (2) të këtij neni nuk mund të arrijë më tepër se 300.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës.

(4) Në bashkëpunimin afarist të paragrafit (1) të këtij neni nuk merren parasysh furnizimet e bëra nga ndërmarrjet publike (energji elektrike, karburantet, gaz, uji, shërbimet komunale, shërbimet e telekomit, etj.) si dhe shërbimet e avokatit, ato kontabiliste ose konsultuese.

(5) Mbështetja financiare e paragrafit (1) të këtij neni nuk mund të paguhet për periudhë kohore më të gjatë se pesë vjet..

Neni 18

Për realizimin e së drejtës së mbështetjes financiare të nenit 17 të këtij ligji, shfrytëzuesi duhet të bëjë furnizime nga furnizuesit të cilët nuk janë lidhur në formë kapitale ose çfarëdo mënyre tjetër në përputhje me ligjin me shfrytëzuesin e mbështetjes financiare dhe të cilët ushtrojnë procese dhe operacione të mëparshme mbi produktin që dorëzohet dhe përfshihet në produktin e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare.

Neni 19

Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare nga neni 17 i këtij ligji ka për obligim ta mbajë veprimtarinë së paku pesë vjet duke llogaritur nga viti i fundit për të cilin është paguar mbështetja financiare.

Mbështetja financiare për vendosjen e formave organizative për zhvillim teknologjik dhe hulumtim

Neni 20

(1) Mbështetja financiare për vendosjen e formave organizative për zhvillim teknologjik dhe hulumtim ndahet për vendosjen e njërive, qendrave ose formë tjetër të strukturës organizative, në të cilat realizohen projekte të qëndrueshme hulumtuese dhe zhvillimore dhe/ose angazhohet personali i kualifikuar i lartë me qëllim të përvetësimit të diturive dhe shkathtësive të reja për zhvillimin e produkteve, proceseve prodhuese dhe shërbimeve të reja, ose për përmirësim të konsiderueshëm të produkteve, proceseve prodhuese dhe shërbimeve ekzistuese në veprimtaritë prodhuese, me përjashtim të prototipave.

(2) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) i këtij neni u ndahet subjekteve afariste që do të formojnë forma organizative të mëvetësishme për zhvillim teknologjik dhe hulumtim, ose do të formohen si pjesë e strukturës organizative ekzistuese.

(3) Mbështetja financiare e paragrafit (1) të këtij neni është deri 50% të shpenzimeve të përgjithshme të arsyeshme investuese për hulumtim industrial, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë denari sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës për kohëzgjatjen e projektit investues.

(4) Shpenzime të arsyeshme investuese të paragrafit (1) të këtij neni janë:

- shpenzimet për personelin (hulumtues, personel teknik dhe kuadër tjetër mbështetjes, të punësuar ose të angazhuar në projektin për hulumtim) deri nivelin në të cilin personeli është i punësuar ose i angazhuar për nevojat e projektit hulumtues;
- shpenzimet për instrumente, makina dhe pajisje të reja që shfrytëzohen për nevojat e projektit hulumtues, deri nivelin në të cilin të njëjtët përdoren për nevojat e projektit hulumtues;
- shpenzimet për ndërtesa dhe truallin ku do të vendoset formë organizative për zhvillim teknologjik, deri nivelin në të cilin të njëjtët përdoren për nevojat e projektit hulumtues;
- shpenzimet për hulumtim të kontraktuar, dituri teknike dhe patenta, të blera ose të licencuara nga burime të jashtme, me çmime të tregut, si dhe shpenzime për shërbime konsultuese dhe ekuivalente që përdoren vetëm për aktivitete hulumtuese;
- shpenzimet plotësuese të krijuara drejtpërdrejt si rezultat i projekteve hulumtuese; dhe
- shpenzimet tjera operative, duke përfshirë edhe shpenzimet për materiale, furnizime dhe prodhime të ngjashme të krijuara drejtpërdrejt si rezultat i veprimtarisë hulumtuese.

(5) Mbështetja financiare nga paragrafi (3) i këtij neni paguhet për periudhë kohore jo më gjatë se pesë vjet.

Neni 21

I fshirë **8**

Mbështetja financiare për projektet investuese me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë së Veriut

Neni 22

Projekte investuese me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë së Veriut janë:

- projekte investuese shpenzimet e arsyeshme investuese arrijnë së paku 4.000.000 euro dhe në kuadër të të cilave krijohen të paktën 300 vende të reja pune; ose
- projekte investuese shpenzimet e arsyeshme investuese e të cilave arrijnë të paktën 15.000.000 euro **9**

Neni 23

Mbështetja financiare për projekte investuese me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë së Veriut përbëhet nga:

a) pagesa e mjeteve në lartësi të tatimit të paguar për të ardhurat personale nga pagat e personave të sapo punësuar, shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke filluar nga data e fillimit të projektit investues;

b) pagesa e mjeteve financiare në lartësinë e tatimit të paguar të fitimit, që rezulton vetëm nga aktivitetet në kuadër të projektit investues;

c) mjete financiare me vlerë deri 10% të shpenzimeve të përgjithshme investuese (mjete materiale dhe jomateriale) të realizuara në kuadër të projektit investues, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë denari sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës;

ç) pagesa e mjeteve financiare për secilin person të sapo punësuar për të cilin është paguar vazhdimisht pagë neto më e lartë për të paktën 50% nga lartësia e pagës minimale neto të përcaktuar me Ligjin e Rrogës Minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, edhe atë:
- vlerë prej 2.000 euro në kundërvlerë denari sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës, për 300 personat e sapopunësuar në kuadër të projektit investues;

- vlerë prej 3.000 euro në kundërvlerë denari sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës, vetëm për pjesën e të sapo punësuarve nga 301 deri 500 persona;

- vlerë prej 3.500 euro në kundërvlerë denari sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës, vetëm për pjesën e të sapo punësuarve nga 501 deri 1000 persona;

- vlera prej 4.000 euro në kundërvlerë denari sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës, vetëm për pjesën e të sapo punësuarve nga 1.001 deri 2.000 persona.

(2) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) pika a) dhe b) e këtij neni nuk mund t'u ndahet shfrytëzuesve që shfrytëzojnë mbështetje financiare të llojit të njëjtë në pajtim me ligjin.

(3) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) pika v) e këtij neni nuk mund t'u ndahet shfrytëzuesve që shfrytëzojnë mbështetje financiare të nenit 25 të këtij ligji.

(4) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) pika g), alinetë 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni nuk u ndahet shfrytëzuesve që shfrytëzojnë mbështetje financiare nga neni 15 i këtij ligji.

Neni 24

(1) Mbështetja financiare sipas nenit 23 paragrafi (1) pika a) të këtij ligji realizohet në nivel vjetor në kohëzgjatje prej dhjetë vitesh duke llogaritur nga muaji në të cilin fillon projekti investues.

(2) Mbështetja financiare të nenit 23 paragrafi (1) pika b) e këtij ligji realizohet në nivel vjetor në kohëzgjatje prej dhjetë vitesh duke llogaritur nga data kur fillon projekti investues, duke llogaritur nga viti i lidhjes së marrëveshjes për mbështetje financiare.

(3) Mbështetja financiare të nenit 23 paragrafi (1) pika c) të këtij ligji realizohet në nivel vjetor për periudhë prej pesë vitesh duke llogaritur nga data e fillimit të projektit investues.

(4) Mbështetja financiare të nenit 23 paragrafi (1) pika ç) alinetë 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji do të paguhet njëhershëm për çdo vend të ri të krijuar të punës në nivel vjetor për periudhë prej pesë vitesh duke llogaritur nga data e fillimit të projektit investues.

(5) Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet ta mirëmbajë investimin dhe vendet e sapokrijuara të punës për të cilat është pranuar mbështetja financiare në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) pika ç), për periudhë prej së paku pesë vitesh duke llogaritur nga data e përfundimit të projektit investues.

Mbështetja financiare për rritje të investimeve dhe të hyrave kapitale

Neni 25

(1) Mbështetja financiare për rritje të investimeve dhe të hyrave kapitale është mbështetje për subjekte afariste që realizojnë investime fillestare ose plotësuese për furnizim të makinave dhe pajisjeve të reja dhe/ose për investime në objekte dhe tokë të nevojshme për veprimtarinë e shfrytëzuesit në kuadër të projektit investues, si dhe për mjete jomateriale.

(2) Shuma vjetore maksimale e mbështetjes financiare nga paragrafi (1) i këtij neni do të jetë 10% nga shpenzimet e arsyeshme investuese,, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës.. 10

(3) Mbështetja financiare të paragrafit (1) të këtij neni do të paguhet në nivel vjetor, por jo më gjatë se pesë vite.

(4) Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet të mirëmbajë investimin për periudhë prej së pesë viteve duke llogaritur nga data e përfundimit të projektit investues.

Neni 26

I fshirë 11

Mbështetja financiare për tjetërsimin e subjekteve afariste në vështirësi

Neni 27

(1) Mbështetja financiare u ndahet subjekteve afariste që do të marrin përsipër subjekte të tjera afariste në vështirësi dhe të cilët do të fillojnë investim fillestar produktiv“.

(2) Shuma maksimale e mbështetjes financiare të paragrafit (1) në këtë nen do të arrijë 10% të shpenzimeve për marrje përsipër të subjektit afarist vështirësi, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë denari sipas kursit mesatar të Bankës Popullor të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës.

(3) Mbështetja financiare të paragrafit (1) të këtij neni paguhet njëhershëm në afat prej 12 muajve, duke llogaritur nga dita e marrjes përsipër të subjektit afarist në vështirësi.

(4) Shfrytëzimi i mbështetjes financiare të paragrafit (1) të këtij neni e përjashton shfrytëzimin e mbështetjes financiare të nenit 25 të këtij ligji.

Neni 28

(1) Për realizimin e mbështetjes financiare të nenit 27 të këtij ligji shfrytëzuesi duhet t'i plotësojë kushtet si më poshtë edhe atë:
- të marrë përsipër subjekt afarist në procedurë për riorganizim të zbatuar në procedurë të hapur të falimentimit;
- të jetë subjekt afarist që në periudhën e tre viteve të fundit para hapjes së procedurës së falimentimit përveç përmes bashkëpunimit afarist nuk ka qenë i lidhur në çfarëdo mënyre me subjektin afarist që është në procedurë të falimentimit;

(2) Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet të fillojë me prodhimin më së voni në periudhë prej dy viteve nga marrja përsipër e subjektit afarist në vështirësi.

(3) Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet të mirëmbajë projektin investues për periudhë prej pesë viteve duke llogaritur nga data e përfundimit të projektit investues.

Mbështetje financiare për rritje të konkurrencës së tregut

Neni 29

(1) Mbështetja financiare për subjekte afariste që e kanë rritur aftësinë e tyre konkurruese në tregun ndahet për rritje të realizuar të të ardhurave nga puna.

(2) Shuma maksimale vjetore e mbështetjes financiare të paragrafit (1) të këtij neni arrin 10% të shpenzimeve të arsyeshme investuese, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë denari me kurs të mesëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës.

(3) Mbështetje financiare të paragrafit (1) të këtij neni do të paguhet në nivel vjetor, por jo më gjatë se pesë vite.

Neni 30

Për realizimin e së drejtës së mbështetjes financiare të nenit 27 të këtij ligji shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet të realizojë rritje të të ardhurave nga punë në vitin e fundit prej së paku 5% në raport me mesataren në tre vitet paraprake ose për periudhë më të shkurtër varësisht nga data në të cilën subjekti afarist është regjistruar dhe ka filluar veprimtarinë.

Mbështetje e barabartë financiare

Neni 31

(1) Me qëllim të kontributit drejt zhvillimit të barabartë rajonal, shfrytëzuesit e mbështetjes financiare do të marrin mbështetje plotësuese financiare varësisht nga rajoni i planifikimit ku realizohet investimi produktiv fillestar.

(2) Mbështetja plotësuese financiare do të përlogaritet si dallim procentual mes rajonit të planifikimit me vlerë më të lartë të PBB-së për kokë banori dhe vlerën e PBB për kokë banori në rajonin e planifikimit në të cilin realizohet investimi produktiv fillestar.

(3) Mbështetja plotësuese financiare të paragrafit (2) e këtij neni do të aplikohet mbi vlerën e aprovuar të mbështetjes financiare për vitin me të cilin ka të bëjë kërkesa për pagesë.

(4) Për nevojat e përlogaritjes së mbështetjes plotësuese të paragrafit (2) të këtij neni do të përdoren të dhënat e fundit të arritshme për PBB-në për kokë banorë sipas rajoneve që i publikon Enti Shtetëror i Statistikës i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 32

I fshirë **12**

Mbështetje financiare për subjekte afariste të themeluara nga shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut

Neni 33

(1) Për investime produktive fillestare të subjekteve afariste të themeluara nga shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që kanë ose kanë pasur qëndrim të rregulluar të përhershëm ose të përkohshëm jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhë prej pesë viteve, deri ditën e parashtrimit të kërkesës, vlera e mbështetjes financiare të nenit 23 paragrafi (1) nën c), neni 25 paragrafi (2), neni 27 paragrafi (2), dhe neni 29 paragrafi (2) të këtij ligji rritet për 15% të shpenzimeve të arsyeshme investuese, por jo më shumë se 1.000.000 euro me kundërvlerë denari sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës, në nivel vjetor.

(2) Shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut të paragrafit (1) të këtij neni, duhet të posedojnë së paku 51% e pronësisë së subjektit afarist, gjatë parashtrimit të kërkesës për pagesë, si dhe për gjithë qasjen e vlefshmërisë së marrëveshjes për mbështetje financiare.

Ndarje të mbështetjes financiare

Neni 34

(1) Mbështetjen financiare në pajtim me këtë ligj e ndan Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Marrëveshjet për mbështetje financiare në emër të Qeverisë i nënshkruan njëri nga nënshkruesit si më poshtë: **13**

- Zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, përgjegjës për çështje ekonomike, bashkërendim të resorëve ekonomikë dhe të investimeve”;

- Ministri i Ekonomisë;

- Drejtori i Drejtorisë së Zonave Zhvillimore Industriale Teknologjike dhe

- Drejtori i Agjencisë së Investimeve të Huaja dhe të Promovimit të Eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mjetet për mbështetje financiare

Neni 35

(1) Mbështetje financiare sipas neneve 15, 17, 20, 23, 25, 27, 29, 31 dhe nenit 33 të këtij ligji aprovohet deri vlerën e mjeteve për atë qëllim të përcaktuara në buxhetin për vitin rrjedhës të institucioneve kompetente për pagesë.

(2) Nëse në bazë të projeksionit për llojin e shumës maksimale të mbështetjes financiare tejkalohen mjetet e përcaktuara buxhetore për këtë dedikim, pagesa bëhet proporcionalisht sipas shfrytëzuesit të mbështetjes financiare në kuadër të mjeteve të përcaktuara buxhetore për vitin përkatës fiskal. Vlera që i tejkalon mjetet e përcaktuara buxhetore për këtë dedikim paraqet obligim të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Organet kompetente për zbatimin e procedurës për ndarje të mbështetjes financiare

Neni 36

(1) Organe kompetente për zbatimin e procedurës për ndarjen e mbështetjes financiare janë Drejtoria e Zonave Zhvillimore Industriale Teknologjike dhe Agjencia e Investimeve të Huaja dhe e Promovimit të Eksportit.

(2) Për projekte investuese nga zonat zhvillimore industriale teknologjike dhe zonat industriale të drejtuara nga Drejtoria për zonat zhvillimore industriale teknologjike, subjekte afariste parashetrojnë kërkesë për shfrytëzimin e mbështetjes financiare deri te Drejtoria e Zonave Zhvillimore Industriale Teknologjike.

(3) Për projekte investuese jashtë zonave zhvillimore industriale teknologjike dhe zonave industriale të drejtuara nga Drejtoria e Zonave Zhvillimore Industriale Teknologjike, subjektet afariste parashtrojnë kërkesë për shfrytëzimin e mbështetjes financiare deri te Agjencia e Investimeve të Huaja dhe e Promovimit të Eksportit e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Procedura për ndarje të mbështetjes financiare

Neni 37

(1) Për ndarjen e mbështetjes financiare në përputhje me këtë ligj, subjekti afarist parashtron kërkesë deri më 31 maj të vitit rrjedhës për ndarjen e mbështetjes financiare deri te autoritetet kompetente të nenit 36, paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji.

(2) Kërkesës i bashkëngjitet Letër e qëllimeve, plan afarist për projektin investues dhe raportet financiare për tre vitet e fundit ose për periudhë më të shkurtër në varësi të datës në të cilën subjekti afarist është themeluar ose ka filluar veprimtarinë e tij.

(3) Përveç dokumenteve të paragrafit (1) të këtij neni, organi kompetent të nenit 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji mund të kërkojë nga parashtruesi i kërkesës të dorëzojë dokumente të tjera me të cilat vërtetohen të dhënat dhe faktet e përmendura në kërkesën për ndarjen e mbështetjes financiare.

(4) Ministri i Ekonomisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës të paragrafit (1) të këtij neni si dhe dokumentacionin e nevojshëm të paragrafit (3) të këtij neni.

Neni 38

(1) Organet kompetente të nenit 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji më së voni deri fund të muajit rrjedhës i shqyrtojnë kërkesat e mbërritura në muajin paraprak dhe dokumentacionin e dorëzuar me ç'rast e përcaktojnë kompletimin e kërkesës dhe dokumentacionit të dorëzuar, në bazë të së cilës përpilojnë raport me shkrim për kërkesat e shqyrtuara".

(2) Nëse kërkesat e dorëzuara dhe dokumentacioni të paragrafit (1) të këtij neni nuk janë të kompletuara organet kompetente të nenit 36 paragrafi (2) dhe (3) të këtij ligji dorëzojnë njoftim në afat prej tetë ditëve nga shqyrtimi i kërkesës deri te kërkuese me rekomandim për plotësimin e kërkesës së parashtruar me dokumentacionin e nevojshëm në afat prej 14 ditëve nga dita e dorëzimit të njoftimit.

(3) Nëse kërkuesi nuk vepron në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni organet kompetente të nenit 36 paragrafi (2) dhe (3) të këtij ligji do ta njoftojnë kërkuesin që në afat prej tetë ditëve nga skadimi i afatit për plotësimin e kërkesës, se kërkesa për shkak të moskompletimit nuk do të jetë objekt i shqyrtimit në procedurën për ndarjen e mbështetjes financiare.

(4) Organet kompetente të nenit 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji në Komisionin për vlerësimin e kërkesave për ndarjen e mbështetjes financiare për investime të formuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e më tutjeshëm: Komisioni i vlerësimit) në afat prej tetë ditësh e dorëzon raportin me shkrim të paragrafit (1) të këtij neni me të gjitha kërkesat me dokumentacion e duhur të kompletuar.

(5) Komisionin e vlerësimit sipas paragrafit (4) të këtij neni e përbejnë anëtarë i Kabinetit të kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kabineti i zëvendëskryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, përgjegjës për çështje ekonomike, bashkërendim të resorëve ekonomike dhe investimeve, Ministrisë së Ekonomisë dhe anëtarëve të tjerë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(6) Anëtarëve të Komisionit të vlerësimit u takon kompensim të cilin e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të numrit të kërkesave të shqyrtuara dhe numrit të takimeve të

realizuara. Me punën e Komisionit kryeson anëtari nga Kabineti i zëvendëskryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, përgjegjës për çështje ekonomike, koordinim të resorëve ekonomikë dhe investimeve.

(7) Për mënyrën e punës së tij Komisioni i vlerësimit miraton Rregullore pune.

(8) Komisioni i vlerësimit e shqyrton raportin me shkrim me kërkesat e pranuar dhe dokumentacionin të paragrafit (4) të këtij neni dhe në afat prej 15 ditëve nga pranimi i të njëjtave përpilon Raport dhe ua dorëzon organeve kompetente të nenit 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji. Raporti përmban: numër i kërkesave të pranuar dhe lloji i mbështetjes financiare, lista e subjekteve afariste dhe projekte kërkesat e të cilave i përmbushin kushtet për lidhjen e marrëveshjes për mbështetje financiare, si dhe mendim për plotësimin e kushteve për marrjen e mbështetjes financiare në përputhje me këtë ligj. Raporti duhet të jetë i nënshkruar nga së paku dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

(9) Pas marrjes së Raportit të Komisionit të vlerësimit, organet kompetente të nenit 36 paragrafët (2) dhe (3) dorëzojnë njoftim në afat prej tetë ditësh deri te të gjitha subjektet afariste që nuk i plotësojnë kushtet për lidhjen e marrëveshjes për mbështetje financiare me arsyet për të njëjtat të përcaktuara në Raportin.

Neni 39

Organet kompetente të nenit 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji në bazë të Raportit të Komisionit të vlerësimit të nenit 38 paragrafi (8) të këtij ligji, më së voni në afat prej 15 ditëve nga pranimi i Raportit dorëzojnë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut Draft marrëveshjen për marrjen e pëlqimit për ndarjen e mbështetjes financiare.

Marrëveshje për përkrahje financiare

Neni 40

(1) Marrëveshja për ndarjen e mbështetjes financiare veçanërisht i përmban elementet si më poshtë:

- palë kontraktuese;
- lëndën e Marrëveshjes për ndarjen e mbështetjes financiare;
- llojin e mbështetjes financiare që ndahet me Marrëveshje për ndarjen e mbështetjes financiare;
- të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese;
- afatet për plotësimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërmarra;
- mënyrën e pagesës së mbështetjes financiare;
- dispozitat në rast të mospërmbushjes së obligimeve të ndërmarra;
- dispozita për ndërprerje;
- dispozita për prishje të marrëveshjes;
- dispozita për zgjidhjen e kontesteve;
- dispozita të tjera.

(2) Marrëveshja për mbështetje financiare që nuk i përmban elementet sipas paragrafit (1) të këtij neni është e pavlefshme.

Neni 40-a

Ndryshimi i marrëveshjes për mbështetje financiare

(1) Marrëveshja për mbështetjen financiare të investimeve mund të ndryshohet nëse për një projekt të caktuar investuese, subjekti afarist parashtron kërkesë për zgjerimin e vëllimit të mbështetjes financiare përmes ndarjes së llojit tjetër të mbështetjes financiare të nenit 14 i këtij ligji.

(2) Marrëveshja për mbështetjen financiare të investimeve mund të ndryshohet nëse për një projekt të caktuar investues subjekti afarist parashtron kërkesë për ndryshimin e vlerës minimale të investimit edhe atë e njëjta të rritet pa kufizime ose të zvogëlohet, por jo më shumë se 20% të vlerës së përgjithshme të projektit investues për të cilin është lidhur Marrëveshja për ndarjen e mbështetjes financiare, përveç se për shfrytëzuesit të mbështetjes financiare të nenit 22 të këtij ligji.

(3) Kërkesat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni subjekti afarist mund t'i parashtrojë më së voni deri më 31 maj të vitit rrjedhëse te autoritetet kompetente të nenit 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji.

(4) Periudha në të cilën bëhet ndryshimi i marrëveshjes, nuk mund të jetë më e gjatë se periudha për të cilën është lidhur marrëveshja për mbështetjen financiare të investimeve.

(5) Kërkesave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni u bashkëngjitet dokumentacioni i përcaktuar në nenin 37 paragrafi (2) të këtij ligji.

(6) Procedura vendimmarrëse ndaj kërkesave të paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni, bëhet në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

(7) Autoritetet kompetente të nenit 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, duke u bazuar në raportin e Komisionit të vlerësimit të nenit 38 paragrafi (8) të këtij ligji, më së voni në afat prej 15 ditëve nga marrja e Raportit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dorëzojnë një projektshtojcë të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes për mbështetje financiare të investimeve për marrjen e pëlqimit.

(8) Shtojcën e marrëveshjes të paragrafit (7) të këtij neni e lidhë Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut jo më vonë se 31 korriku i vitit rrjedhës, e në emër të Qeverisë e nënshkruan njëri nga nënshkruesit e përmendur në nenin 34 paragrafi (2) të këtij ligji.

Njoftimi dhe evidenca për marrëveshjen e lidhur për ndarjen e mbështetjes financiare

Neni 41

(1) Autoritetet kompetente të nenit 33 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji mbajnë evidencë të marrëveshjeve të lidhura për ndarjen e mbështetjes financiare dhe në emër të ofruesit të mbështetjes financiare, një herë në vit, dorëzojnë raport vjetor në Komisionin për mbrojtje të konkurrencës, si dhe në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Marrëveshja e lidhur për mbështetje financiare vendoset në evidencën e organit të paragrafit 1 të këtij neni te i cili është parashtruar kërkesa e parë e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare, që është pranuar si e rregullt dhe për të njëjtën është zbatuar procedurë për ndarjen e Marrëveshjen për mbështetjen financiare.

(3) Ofruesi i mbështetjes financiare menjëherë, por më së voni në afat prej 15 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes, duhet t'i dorëzojë një ekzemplar të marrëveshjes për ndarjen e mbështetjes financiare organit që mban evidencë të marrëveshjeve të lidhura për mbështetje financiare.

Përcjellja e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura për ndarjen e mbështetjes financiare

Neni 42

(1) Organet kompetente të nenit 33 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji dhe Ministria e Ekonomisë do të ndjekin dhe ushtrojnë kontroll mbi zbatimin e marrëveshjeve të lidhura për ndarjen e mbështetjes financiare gjatë vlefshmërisë së tyre.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë vendimmarrjes për lidhjen e secilës Marrëveshje për ndarjen e mbështetjes financiare, do të përcaktojë se cili nga organet të paragrafit 1 të këtij neni do të vëzhgojë marrëveshjen në fjalë.

(3) Lloji, mënyra dhe fusha e kryerjes së aktiviteteve për monitorimin dhe kontrollimin e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura përcaktohet nga Ministri i Ekonomisë brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(4) Vëzhgimi i zbatimit të marrëveshjeve në përputhje me këtë nen nuk përjashton kompetencën e organeve të tjera shtetërore dhe autorizimet e tyre për të vepruar në kuadër të kompetencës përkatëse ligjore që ka të bëjë me punën e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare ose projektit investues që ai e realizon.

Pagesa e mbështetjes financiare

Neni 43

(1) Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare që i ka plotësuar kushtet në përputhje me marrëveshjen për mbështetje financiare më së voni deri më 31 gusht të vitit rrjedhës për pagesën e mjeteve në përputhje me marrëveshjen e lidhur për mbështetje financiare dorëzon kërkesë për pagesën e mbështetjes financiare me dokumentacionin e nevojshëm në organin kompetent të nenit 36, paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji.

(2) Organet kompetente të paragrafit (1) të këtij neni e shqyrtojnë Kërkesën për pagesën e mbështetjes financiare dhe pas përcaktimit se janë plotësuar kushtet për shfrytëzimin e mbështetjes financiare të parashikuar me këtë ligj do të kryejë pagesën në vlerën që i takon shfrytëzuesit. **14** Nëse organi kompetent nuk është nënshkrues i marrëveshjes për mbështetje financiare, kërkesa e shqyrtuar i dorëzohet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për ta bërë pagesën.

(3) Ministri i Ekonomisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm të paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Llojet e shpenzimeve të arsyeshme investuese dhe mënyra e realizimit të pagesës.

Neni 43-a

Subjektet afariste që do të lidhin marrëveshje për mbështetje financiare deri më 31 korrik të vitit rrjedhës, mund të parashirojnë kërkesa për pagesë të mbështetjes financiare për shpenzimet e investimeve të realizuara, për vitin paraprak në përputhje me këtë ligj jo më voni se 31 gusht i vitit rrjedhës.

Neni 43-b

Mbështetja e aprovuar financiare për shpenzimet e realizuara të arsyeshme investuese në vitin paraprak do të paguhet në dy transhe. Transheja e parë në lartësi prej 50% të vlerës së aprovuar të mbështetjes financiare do të paguhet më së voni për 60 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës së kompletuar për pagesë. Transheja e dytë do të paguhet në mënyrë plotësuese, më së voni deri më 25 dhjetor të vitit rrjedhës.

Mbikëqyrja

Neni 44

Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji kryen Ministria e Ekonomisë.

Neni 44-a

Kontrolli i zbatimit të marrëveshjeve për mbështetje financiare

(1) Kontrollin mbi zbatimin e marrëveshjeve për mbështetje financiare të investimeve e kryejnë organet kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji dhe përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë.

(2) Kontroll nga paragrafi (1) i këtij neni kryejnë persona të autorizuar të punësuar në organe kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji dhe Ministria e ekonomisë, me autorizimin për kryerje të kontrollit, të lëshuar nga drejtori i organeve kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji dhe autorizim të lëshuar prej ministrit të Ekonomisë për përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë.

(3) Mënyrën e kryerjes së kontrollit do ta përcaktojë ministri i Ekonomisë.

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Neni 45

Subjektet afariste që do të lidhin marrëveshje për mbështetje financiare nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në fund të korrikut 2018, mund të parashtrojnë kërkesa për pagesën e mbështetjes financiare për shpenzimet investuese të arsyeshme të realizuara në pajtim me këtë ligj më së voni deri më 30.11.2018. Mbështetja e miratuar financiare do të paguhet më së voni deri më 31.12.2018.

Neni 45-a **15**

(1) Subjektet afariste të industrisë së përpunimit të lëkurave dhe të tekstitit, më së voni në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të parashtrojnë kërkesa për pagesën e mbështetjes financiare për realizimin e shpenzime të arsyeshme investuese me ç'rast për këto subjekte afariste nuk zbatohen kufizimet nga neni 9 paragrafi (1) alineja 3 të këtij ligji.

(2) Subjektet afariste nga paragrafi (1) i këtij neni mund të parashtrojnë kërkesa për pagesën e mbështetjes financiare për realizimin e shpenzimeve të arsyeshme investuese, vetëm në rastin kur kanë realizuar rritje të të hyrave nga veprimtaria në vitin e fundit në raport me mesataren nga tri vitet paraprake ose për periudhë më të shkurtër nëse subjekti afarist është regjistruar dhe ka filluar me veprimtari në periudhë më të shkurtër se katër vite, duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kërkesës për ndarjen e mbështetjes financiare.

Miratimi i akteve nënligjore

Neni 46

Aktet nënligjore, të parapara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Zbatimi i dispozitave të caktuara

Neni 47

(1) Subjektet afariste që janë shfrytëzues të zonave zhvillimore teknologjike industriale dhe të cilat deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji kanë lidhur marrëveshje për ndihmë shtetërore në pajtim me Ligjin për zonat zhvillimore teknologjike industriale dhe të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj mund të parashtrojnë kërkesë për ndarjen e mbështetjes financiare.

(2) Subjektet afariste të cilat deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji që kanë lidhur marrëveshje për ndihmë shtetërore në pajtim me Ligjin për kontroll të ndihmës shtetërore dhe të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj mund të parashtrojnë kërkesë për ndarjen e mbështetjes financiare.

Hyrja në fuqi

Neni 48

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.

DISPOZITA	NGA	NJË	LIGJ	TJETËR
Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje financiare të investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/2019): Neni				32
(1) Subjektet afariste që kanë lidhur marrëveshje për mbështetje financiare të investimeve në pajtim me Ligjin për mbështetje financiare të investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 83/18), mund të parashtrojnë kërkesë për ndryshimin e marrëveshjeve për shkak të harmonizimit me dispozitat e këtij ligji, më së voni deri më 1 gusht 2019. 16				
(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet në organet kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) të Ligjit për mbështetje financiare të investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 83/18) për nënshkrim të aneksit të marrëveshjes për mbështetje financiare të investimeve.				
(3) Procedura për vendosje për kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhet në pajtim me nenin 38 të Ligjit për mbështetje financiare të investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 83/18).				
(4) Aneksin e marrëveshjes nga paragrafi (2) të këtij neni e nënshkruan Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më së voni deri më 15 tetor 2019, kurse në emër të Qeverisë e nënshkruan njëri prej nënshkruesve të shënuar në nenin 34 paragrafi (2) të Ligjit për mbështetje financiare të investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 83/18). 17				
(5) Nëse subjektet afariste nuk lidhin Aneks në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni., realizimi i mbështetjes financiare do të zhvillohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbështetje financiare të investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 83/18). 18				
Neni				33
Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.				
Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje financiare të investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/2019): Neni				34
Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".				
Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje financiare të investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 124/2019): Neni				9
Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".				

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje financiare të investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 178/2021):

Neni 44

(1) Subjektet afariste që kanë lidhur anekse të marrëveshjeve për mbështetje financiare të investimeve në përputhje me nenin 32 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Mbështetjes Financiare të Investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 98/19) mund të parashtrorjnë kërkesë për ndryshim të marrëveshjeve në mënyrë që të harmonizohet me dispozitat e këtij ligji, jo më vonë se 16 gusht të vitit 2021.

(2) Kërkesa sipas paragrafit (1) të këtij neni parashtrorhet te autoritetet kompetente të nenit 32, me çka ndryshohet neni 36 i këtij ligji, për lidhjen e shtojcës së marrëveshjes për mbështetjen financiare të investimeve.

(3) Procedura e vendimmarrjes ndaj kërkesës të paragrafit (1) të këtij neni, bëhet në përputhje me nenin 33, me të cilin ndryshohet neni 37 të këtij ligji.

(4) Shtojcën e marrëveshjes sipas paragrafit (2) të këtij neni e lidhë Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më së voni deri më 14 tetor të vitit 2021, e në emër të qeverisë nënshkruhet njëri nga nënshkruesit e përmendur në nenin 30 me të cilin ndryshohet neni 34 të këtij ligji.

(5) Nëse subjektet afariste nuk lidhin Shtojcë të Marrëveshjes në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni, realizimi i mbështetjes financiare do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Mbështetjes Financiare të Investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 83/18, 98/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 24/19)".

Neni 45

(1) Subjektet afariste që kanë rënie deri 15% të të ardhurave të përgjithshme nga puna në vitin 2020 në raport me mesataren e tre viteve paraprake ose për një periudhë më të shkurtër nëse subjekti afarist është i regjistruar dhe ka filluar veprimtarinë në periudhë më të shkurtër se katër vite, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të kërkesës për ndarjen e mbështetjes financiare, mund të parashtrorjnë kërkesë për ndarjen e mbështetjes financiare në përputhje me dispozitat e këtij ligji, deri më 16 gusht të vitit 2021.

(2) Kërkesa sipas paragrafit (1) të këtij neni u parashtrorhet organeve kompetente të nenit 32, me të cilin ndryshohet neni 36 të këtij ligji.

Neni 46

Subjektet afariste që kanë lidhur marrëveshje për mbështetje financiare të investimeve në të cilën është përfshirë masa mbështetje për përvetësimin e tregjeve të reja dhe rritje të shitjes në përputhje me nenet 31 dhe 32 të Ligjit të Mbështetjes Financiare të Investimeve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 83/18, 98/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 124/19), vazhdojnë të shfrytëzojnë këtë lloj të mbështetjes financiare në përputhje me marrëveshjen për mbështetje financiare që është lidhur në bazë të dispozitave të Ligjit të Mbështetjes Financiare të Investimeve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 83/18, 98/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 124/19).

Neni 47

(1) Subjektet afariste që i plotësojnë kushtet për ndarjen e mbështetjes financiare në përputhje me këtë ligj, për vitin 2021, mund të parashtrorjnë kërkesë në përputhje me nenin 33 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 37 paragrafi (1) deri më 16 gusht të vitit 2021.

(2) Subjektet afariste që i plotësojnë kushtet për ndarjen e mbështetjes financiare në përputhje me këtë ligj, për vitin 2021, mund të parashtrorjnë kërkesë në përputhje me nenin 37 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 40-a paragrafi (3) deri më 16 gusht të vitit 2021, ndërsa aneksi i marrëveshjes të nenit 37 me të cilin ndryshon neni 40-a paragrafi (8) mund të ndodhë jo më vonë se 14 tetor të vitit 2021.

(3) Subjektet afariste që i plotësojnë kushtet për ndarjen e mbështetjes financiare në përputhje me këtë ligj, për vitin 2021, mund të parashtrorjnë kërkesë në përputhje me nenin 40 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 43 paragrafi (1) deri më 15 nëntor të vitit 2021.

(4) Subjektet afariste që i plotësojnë kushtet për ndarjen e mbështetjes financiare në përputhje me këtë ligj, për vitin 2021, mund të parashtrorjnë kërkesë në përputhje me nenin 41 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 43-a deri më 15 nëntor të vitit 2021.

Neni 48

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje financiare të investimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 178/2021):
Neni 49
Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".